



**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional**

**STANDARDI I PROFESIONIT
Prodhues i dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika
Niveli 3**

**Sektori: Prodhim dhe përpunim
Nënspektori: Materiale (xham, letër, plastikë, dru)**

Kodi ISCO88: 8232.01 operator i makinave, prodhimi i dyerve dhe dritareve të plastikes

Kodi OSCO08: 8142 Operator i makinave për prodhime të plastikes:

Data e aprovimit:

Ky standard i profesionit është zhvilluar në kuadër të Projektit ALLED "Harmonizimi i Arsimit me Kërkesa të Tregut të Punës (Kosovë)"

Ekipi i zhvillimit:

Koordinator i ekipit:

Blerim Osmani

Anëtarë:

Ferki Namani

Enver Osdautaj

Data e aprovimit:

Valide:

Profesioni: PRODHUES I DYERVE DHE DRITAREVE NGA ALUMINI DHE PLASTIKA, NIVELI 3 I KKK

Standardi i profesionit është dokument që përshkruan kërkesat dhe kompetencat e kërkuara për këtë nivel, si tërësi të njohurive, shkathtësive dhe shprehive/qëndrimeve të nevojshme për të kryer me sukses detyrat e punës për profesione të caktuara.

Standardi i profesionit për Prodhues i dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika, nivelet 3 dhe 4 KKK është baza për zhvillimin e kurrikulës për fushën e përpunimit dhe teknologjisë së materialeve dhe vlerësimin e kompetencave profesionale të kandidatëve.

Përshkrimi i profesionit:

Prodhues i dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika mbulon teknologjitë të cilat merren me prodhimin e dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika (dyer te hyrjes, dyer ngritëse dhe rrëshqitëse, dyer ballkoni, dyer te brendshme, dritare me hapje paralele dhe ne kënd, dritare rrethore dhe këndore) duke përzgjedhur gjysmëfabrikatet ne përputhje me kërkesat e tregut te punës si mbrojtës nga zhurma dhe temperature, dizajnit te sipërfaqeve , skicimin e sipërfaqes-lokacionit ku vendosen dyerve dhe dritareve, përzgjedhjen e teknologjive për prodhim, matjen dhe kontrollin e produkteve, montimin e dyerve dhe dritareve ne ambiente te ndryshëm dhe riparimin e mirëmbajtjen e dyerve dhe dritareve. Me të përfunduar shkollimin kandidati do të ketë këto njohuri, aftësi të përgjithshme dhe profesionale, aftësi intelektuale dhe të transferueshme.

PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS

Prodhuesit e dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika punësohen kryesisht në ndërmarrje që prodhojnë **dyer dhe dritareve nga alumini dhe plastika**, në të cilat ai / ajo do të përfshihen në prodhim dyer dhe dritare te llojeve te ndryshme nga alumini dhe plastika, sipas vizatimeve dhe programit. Detyrat kryesore të një prodhuesi te **dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika** janë përpunimi i te gjitha pjesëve për dyer e dritare duke bërë prerjen, frezimin shpimi e gjysmëfabrikatit, montimin e këtyre elementeve sipas vizatimit te punës, montimin e xhamave apo paneleve ne dyer dhe dritare, montimin e dyerve dhe dritareve ne ambiente te ndryshëm dhe riparimin e mirëmbajtjen e dyerve dhe dritareve te vjetra, merr dhe përpunon porosi nga konsumatoret, jep informata kthyesë me goje apo me shkrim sa here ato kërkohen nga punëdhënësi apo konsumatoret.

Niveli 3

Kandidati qe kryen profesionin **Prodhues i dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika** është një punëtor i përgatitur me shkathtësi për përpunimi te materialeve, përzgjedhjen e materialeve, veglave, pajisjeve dhe makinave adekuate për prodhime te përcaktuara. Detyrat e tij/saj kryesore janë qe të **Prodhoj dhe mirëmbajë dyer dhe dritare nga alumini dhe plastika** me makina konvencionale apo automatike duke zbatuar ecurit teknologjike

ne funksion te arritjes se cilësisë sipas standardit dhe kërkesave të përcaktuara me dokumentacion tekniko-teknologjik.

Personi me kualifikimet e niveleve 3 i KKK punon në mënyrë të pavarur apo në ekip duke qenë përgjegjës për rezultatet e punës së ekipit. Ai/ajo përzgjedh dhe zbaton teknologji dhe metoda të ndryshme për gjetjen e zgjidhjeve të reja duke marrë parasysh gjithashtu edhe eficientë e energjisë, principet e ekonomisë dhe qëndrueshmërisë ambientale.

Përveç aktiviteteve specifike profesionale, detyre e **Prodhuesit e dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika** është mbikëqyrja e ekipit, këshillimi i klientëve, ndarja e resurseve dhe delegimi i punëve dhe bashkëpunimi me specialistë të tjerë të fushave relevante të aktivitetit.

Njerëzit që punojnë në fushën **Prodhimit të dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika** u kërkohet të kenë njohuri dhe shkathtësi për punë dore dhe të kuptojnë procesin e përpunimit me më shumë metoda, për të patë kontroll më të madhe mbi saktësinë e dimensioneve dhe ruajtjen e standardeve të cilësisë.

Aftësitë kryesore që njihen me këtë kualifikim janë aftësia për të monitoruar dhe kontrolluar rrjedhën e punës, të monitorojë sigurinë, shëndetin dhe praktikat mjedisore për të siguruar cilësinë e prodhimit. Këto aftësi kërkojnë njohuri të teorisë përpunimit; funksionimit të makinave, materialet, proceset e prodhimit, kontrollin statistikor të procesit dhe zgjidhjen e problemeve.

Prodhuesit e kualifikuar **për dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika** gjithashtu kuptojnë:

- Si të mirëmbajnë proceset e prodhimit dhe për të kryer llogaritje të thjeshta ekonomike.
- Rolin e tyre në punë dhmth në prodhim dhe aktivitete që lidhen me prodhimin.
- Cilat janë kërkesat ligjore, rregulloret, marrëveshjeve dhe politikat që lidhen me mjedisin e veçantë e tyre të punës.

Prodhuesit e dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika duhet të jenë në gjendje të:

- Skicoj vizatime të thjeshta dhe Interpretojë vizatimet me saktësi dhe në mënyre efikase dhe kryen përpunimin e pjesëve duke shfrytëzuar llogaritje të thjeshta matematikore.
- Operon me makina konvencionale dhe automatike, ashtu siç kërkohet.
- Përpunon materialet nga alumini dhe plastika për të kryer përpunimin e elementeve të dyerve dhe dritareve në mënyre të sakta dhe brenda afatit kohor.
- Përdor vegla të ndryshme duke përfshirë, veglat për prerje, frezim dhe shpim, ngjitje të PVC-së, veglat e dorës, mjetet e ndryshme për matje dhe kontrolle në mënyrën e duhur për të kontrolluar në mënyre plote pjesët e përpunuara.

- Kryen mirëmbajtjen e rregullt dhe punët e pastrimit të veglave dhe pajisjeve dhe evidenton problemet teknike.
- Kryen prodhimin, montimin, demontimi dhe mirëmbajtjen e dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika.
- Monton dyer dhe dritare nga alumini në objekte të ndryshme.
- Demonton apo riparon dyer dhe dritare nga alumini në objekte të ndryshme.
- Kryen llogaritje të thjeshta ekonomike.
- Ambalazhon dhe deponon pjesët e përpunuara brenda vendit të punës.
- Mirëmban vendin e punës, duke i larguar të gjitha mbeturinat e krijuara gjatë procesit të prodhimit. Kjo përfshin klasifikimin e mbeturinave sipas udhëzimeve.
- Mirëmban vendin e punës në gjendje të pastër dhe të rregullt.
- Vëzhgon rregullat e përshkruara të sigurisë.
- Numëron dhe mban shënime sipas udhëzimeve të dhëna.
- Përgatite raportet e punës.
- Zbulon dhe raporton të udhëheqësi dështimet e operacioneve të punës, materialet me defekte dhe çdo situatë të pazakontë apo të pasigurtë.
- Komunikon me gojë ose me shkrim me koleget dhe stafin mbikëqyrës (menaxhues) duke dhënë informata të përmbledhura dhe shpreh mendimin për informacionin e dhënë.

Kandidati mund të vlerësohet në:

- Një qendër e aftësisë profesionale, shkolle, ndërmarrje prodhuese.
- Një makinë konvencionale dhe automatike
- Ose me pajisje të tjera të përpunimit me prerje, p.sh, shpim, frezim.

Profesioni: Prodhimi i dyerve dhe dritare nga alumini dhe plastika

	Funksioni	Përshkrimi i funksionit
1.	Përgatitja e procesit të punës	<p>Aktivitetet kyç: Ky funksion ka të bëjë me skicimin e elementeve dhe leximin e vizatimit të punës dhe dokumentacionit teknik, organizimin e vendit të punës dhe verifikimin e gjendjes teknike të veglës dhe makinës.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Skicon elemente dhe lexon vizatimet punuese dhe dokumentacionin teknologjik 2. Organizon si duhet vendin e punës 3. Verifikon gjendjen teknike të veglave dhe pajisjeve
2.	Kryerja e punëve në mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinave	<p>Aktivitetet kyç: Ky funksion ka të bëjë me mirëmbajtjen e rregullt të veglave dhe pajisjeve, pastrimin, regjistrimin e problemeve teknike të veglave dhe pajisjeve.</p>

		<ol style="list-style-type: none"> 1. Kryen mirëmbajtjen e rregullt dhe punët e pastrimit të veglave dhe pajisjeve 2. Evidenton problemet teknike
3.	Prodhimi, montimi, demontimi dhe mirëmbajtja e dyerve dhe dritareve nga alumini	<p>Aktivitetet kyç:</p> <p>Ky funksion ka të bëjë me prodhimin e dyerve dhe dritareve nga alumini, përpunon pjesët e dyerve dhe dritareve me makina automatike, monton pjesët, xhamat- panelet në dyer dhe dritare, ambalazhon dhe deponon pjesët e përpunuara brenda vendit të punës, po ashtu demonton dhe monton dyer dhe dritare në ambiente të ndryshme dhe bene llogaritje të thjeshta ekonomike.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatit veglat dhe pajisjet për prodhimin e dyerve dhe dritareve nga alumini 2. Përpunon pjesët e dyerve dhe dritareve nga alumini. 3. Monton dyer dhe dritare nga alumini në objekte të ndryshme 4. Demonton apo riparohet dyer dhe dritare nga alumini në objekte të ndryshme 5. Kryen detyra ekonomike 6. Zbaton rregullat e sigurisë dhe ruajtjes së mjedisit. 7. Ambalazhon dhe deponon pjesët e përpunuara brenda vendit të punës.
4.	Prodhimi, montimi, demontimi dhe mirëmbajtja e dyerve dhe dritareve nga plastika-PVC	<p>Aktivitetet kyç:</p> <p>Ky funksion ka të bëjë me prodhimin e dyerve dhe dritareve nga plastika PVC, përpunon pjesët e dyerve dhe dritareve me makina automatike, monton pjesët, xhamat- panelet në dyer dhe dritare ambalazhon dhe deponon pjesët e përpunuara brenda vendit të punës, po ashtu demonton dhe monton dyer dhe dritare në ambiente të ndryshme dhe bene llogaritje të thjeshta ekonomike.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatit veglat dhe pajisjet për prodhimin e dyerve dhe dritareve nga PVC. 2. Përpunon pjesët e dyerve dhe dritareve nga PVC. 3. Monton dyer dhe dritare nga alumini në objekte të ndryshme 4. Demonton apo riparohet dyer dhe dritare nga PVC në objekte të ndryshme 5. Kryen detyra ekonomike 6. Zbaton rregullat e sigurisë dhe ruajtjes së mjedisit. 7. Ambalazhon dhe deponon pjesët e përpunuara nga PVC brenda vendit të punës.

Funksioni 1: Përgatitja e procesit të punës

Ky funksion ka të bëjë me skicimin e elementeve dhe leximin e vizatimit të punës dhe dokumentacionit teknik, organizimin e vendit të punës dhe verifikimin e gjendjes teknike të veglës dhe makinës.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e Përformancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
1. Skicon elementet dhe format e dyerve e dritareve dhe lexon vizatimet punuese dhe dokumentacionit teknologjik	<ol style="list-style-type: none">Skicon elemente e dyerve dhe dritareve dhe dokumentet e nevojshme (p.sh. renditjen e punëve, kërkesat teknike, kërkesat e konsumatorit- dyer të hyrjes, ngritëse dhe rrëshqitëse, dritare me hapje paralele dhe në krah, rrethore dhe këndore, dyer ballkoni, dyer të brendshme);Lexon vizatimet e punës dhe dokumentet e nevojshme (p.sh. renditjen e punëve, kërkesat teknike);Siguron që të gjitha dokumentet e nevojshme janë të pranishme, të qarta dhe të kuptueshme;Kërkon informacione shtese sipas nevojës.	<ol style="list-style-type: none">Interpreton skicat sipas të paraqitura sipas rregullave vizatim teknik;Përshkruan fushat e tolerancës (vendosjet dhe tolerancat);Lexon dokumentacionin punues;Tregon instrumentet për matje dhe shënim të nevojshme për punë (p.sh. vizorja, trekëndëshat, kompasit, lapsat standard teknik etj.) dhe mënyrat e përdorimit të tyre.	<ul style="list-style-type: none">Përgatit vendin e punës;Përgatitja e skicave;Kryen matje;Përzgjedh instrumentet për matje dhe shënim për skicim;Zbaton standardet e profesionit;Zbaton standardet dhe rregullat në punë dhe ruajtje të mjedisit.	<ul style="list-style-type: none">KomunikimiMbledh dhe përpunon informataTë menduarit logjikShkathtësi në zgjidhjen e problemeveTë jetë kritik dhe konstruktivTë manifestoj guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësiTë jetë vendimmarrësMësimi gjatë gjithë jetësPunë në grupVlerësimi dhe vetëvlerësimi
2. Organizon vendin e punës	<ol style="list-style-type: none">Siguron që mjetet e	<ol style="list-style-type: none">Interpreton rregullat e	<ul style="list-style-type: none">Përgatit vendin e	<ul style="list-style-type: none">Komunikimi

	<p>nevojshme në vendin e punës janë në afërsinë e duhur dhe te sigurta;</p> <p>2. Verifikon që pajisjet mbrojtëse personale (p.sh syze, doreza, etj), janë të pranishme dhe në rregull;</p> <p>3. Kontrollon në mënyrë vizuale veglat dhe pajisjet a janë në rregull dhe te pastruara para fillimit të punës;</p> <p>4. Kontrollon mjedisin e punës para fillimit të punës.</p>	<p>sigurisë, masat e sigurisë dhe pajisjet personale mbrojtëse të nevojshme gjatë përdorimit të makinës;</p> <p>b) Përshkruan metodologjinë e të kontrollit të veglave, pajisjeve dhe hapësirës punuese të punës;</p> <p>c) Përshkruan materialet: material të ndryshme metalike dhe jo-metalike, dallimet mes tyre (vetitë fizike dhe mekanike, aluminit, plastikes dhe çelikut, duke përdorë standardet e nevojshme EN dhe ISO, etj);</p> <p>d) Përshkruan llojet e makinave për prodhimin e dyerve dhe dritareve të aluminit dhe mundësit teknike të tyre;</p> <p>e) Përshkruan metodat për monitorimin e funksionimit të një makine si dhe shenjat</p>	<p>punës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja organizative e procesit të punës; - Përzgjedh veglat dhe pajisjet e punës; - Zbaton standardet e profesionit në përzgjedhje të materialeve; - Zbaton standardet dhe rregullat në punë dhe ruajtje të mjedisit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Mbledh dhe përpunon informata - Të menduarit logjik shkathtësi në zgjidhjen e problemeve - Të jetë kritik dhe konstruktiv - Të manifestoj guxim dhe iniciativë në marrje të përgjegjësi - Të jetë vendimmarrës - Mësimi gjatë gjithë jetës - Punë në grup - Vlerësimi dhe vetëvlerësimi
--	---	--	--	--

		paralajmëruese të dështimit.		
3. Verifikon gjendjen teknike të veglave dhe pajisjes	<ol style="list-style-type: none"> 1. Teston veglat dhe pajisjet; 2. Aktivizon makinën; 3. Monitoron që të mos ketë devijime në punën e pajisjeve kurse në rast të devijimeve, reagon sipas udhëzimeve; 4. Njofton specialistin ose menaxherin e tij/ saj për problemin; 5. Kontrollon përputhshmërinë e gjysmëfabrikatit (gjysmë prodhimit) me vizatimin e punës, duke përdorur instrumente matëse. 	<ol style="list-style-type: none"> a) Përshkruan rolin dhe funksionin e veglave dhe pajisjeve për prodhimin e dyerve dhe dritareve të aluminit dhe plastikes; b) Shpjegon për gjysme fabrikantët; c) Shpjegon karakteristikat e veglave për prodhimin e dyerve dhe dritareve nga Al dhe PVC; d) Përshkruan proceset teknologjike të prodhimit; e) Përshkruan llojet më të zakonshme të dështimeve për prodhimin. 	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatit vendin e punës; - Verifikon dhe kontrollon veglat dhe pajisjet; - Kryen matje; - Përzgjedh veglat; - Zbaton standardet e profesionit; - Zbaton standardet dhe rregullat në punë dhe ruajtje të mjedisit; - Harton raport të shkurtër me shkrim për gjendjen e veglës dhe makinës. 	<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi - Mbledh dhe përpunon informata - Të menduarit logjik - Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve - Të jetë kritik dhe konstruktiv - Të manifestoj guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësi - Të jetë vendimmarrës - Mësimi gjatë gjithë jetës - Punë në grup - Vlerësimi dhe vetëvlerësimi

Kushtet e realizimit të funksionit:

Mjetet e punës - Veglat kryesore për prodhimin e dyerve dhe dritareve nga alumini dhe plastika përfshijnë instrumente matëse me dorë (nonius, , shirit matës, kalibra të ndryshëm dhe të tjera si tavolina pune, mengene, dara, kaçavida, çelësa formash dhe dimensionesh standarde për demontimin dhe montimin e pjesëve për dyer dhe dritare nga AL dhe PVC, makina ratifikuese dore, shpuese dore, aparat saldimi, stacion i kompresorit, makina konvencionale dhe makina automatike.

Kërkesat e vlerësimit: Metoda e kombinuar që përmban verifikimin e njohurive teorike si dhe shkathtësi praktike.

Evidenca/dëshmitë e performancës – Dëshmi se personi, kompletion vizatimet e punës dhe dokumentet e nevojshme (p.sh. renditjen e punëve, kërkesat teknike), siguron që të gjitha dokumentet e nevojshme janë të pranishme, të qarta dhe të kuptueshme. Dëshmi se personi siguron që mjetet e nevojshme në vendin e punës jenë në afërsinë e duhur dhe te sigurta. Verifikon që pajisjet mbrojtëse personale (p.sh. syze, dorëza, etj), janë të pranishme dhe në rregull. Dëshmi se personi kontrollon në mënyrë vizuale se vegla dhe pajisja është në rregull dhe e pastruar para fillimit të punës. Dëshmi se personi aktivizon makinën, monitoron që të mos ketë devijime në punën e saj. Dëshmi se personi njofton specialistin ose menaxherin e tij/ saj për problemin. Dëshmi se personi kontrollon përputhshmërinë e gjysmëfabrikatit (gjysmë prodhimit) me vizatimin e punës, duke përdorur instrumente matëse.

Evidenca e njohurive – Test me shkrim, demonstrim praktik i funksioneve dhe kriterëve të performancës nëpërmjet softuerëve përkatës, aktivitete gjatë orëve mësimore, etj.

Funksioni 2: Kryerja e punëve nën mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinave

Ky funksion ka të bëjë me mirëmbajtjen e rregullt të veglave dhe pajisjeve, pastrimin regjistrimin e problemeve teknike të veglave dhe pajisjeve.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e Përformancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
1. Kryen mirëmbajtjen e rregullt dhe punët e pastrimit të veglave dhe pajisjeve.	1. Kryen mirëmbajtje të rregullt të veglave dhe pajisjeve; 2. Pastron pajisjen sipas manualit të prodhuesit.	a) Përshkruan rendësin e mirëmbajtjes; b) Përshkruan mënyra e nderimit dhe funksionimit të veglave dhe pajisjeve; c) Shpjegon afat shërbimin e veglave dhe pajisjeve; d) Përshkruan procedurat për mirëmbajtje të veglave dhe pajisjeve; e) Tregon rregullat e	- Përgatit vendin e punës; - Përzgjedh veglat dhe pajisjet e përshtatshme punë; - Kryen mirëmbajtje të rregullt; - Zbaton standardet e profesionit; - Zbaton standardet dhe rregullat në	- Komunikimi - Mbledh dhe përpunon informata - Të menduarit logjik - Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve - Të jetë kritik dhe konstruktiv - Të manifestoj guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë - Të jetë vendimmarrës

		<p>sigurisë, masat e sigurisë dhe pajisjet personale mbrojtëse të nevojshme gjatë përdorimit të veglave dhe pajisjeve;</p> <p>f) Përshkruan kompletimin e dokumentacionit punues i cili përmban të dhëna për mirëmbajtje dhe pastrim.</p>	<p>punë të ruajtjes së mjedisit;</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Punë në grup - Vlerësimi dhe vetëvlerësimi
<p>2. Evidenton problemet teknike</p>	<p>1. Evidenton të gjitha probleme teknike;</p> <p>2. Informon specialistin apo menaxherin për probleme teknike.</p>	<p>a) Shpjegon metodologjitë e thjeshta përmes vrojtimit në identifikimit të problemeve teknike;</p> <p>b) Tregon llojet më të zakonshme të dështimeve, dhe metodat për parandalimin e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kryen matje; - Identifikon probleme teknike; - Harton raport me shkrim për gjendjen teknike të veglave dhe pajisjeve; - Zbaton standardet e profesionit në punët e mirëmbajtjes; - Zbaton standardet dhe rregullat në punë të ruajtjes së mjedisit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi - Mbledh dhe përpunon informata - Të menduarit logjik - Të jetë kritik dhe konstruktiv - Të manifestoj guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësi - Të jetë vendimmarrës - Punë në grup - Vlerësimi dhe vetëvlerësimi

Kushtet e realizimit të funksionit:

Mjetet e punës - Veglat kryesore të prodhuesit të dyerve dhe dritareve të aluminit dhe plastikes përfshijnë instrumente matëse me dorë (nonius, , shirit matës, kalibra të ndryshëm dhe të tjera si tavolina pune, mengene, dara, kaçavida, çelësa formash dhe dimensionesh standarde për demontimin dhe montimin e pjesëve për dyer dhe dritare nga AL dhe PVC, makina ratifikuese dore, shpuese dore, aparat saldimi, stacioni i kompresorit, makina konvencionale dhe automatike.

Kërkesat e vlerësimit: Metoda e kombinuar që përmban verifikimin e njohurive teorike si dhe shkathtësive praktike.

Evidenca/dëshmitë e performancës – Dëshmi se personi kryen mirëmbajtje të rregullt të makinës. Dëshmi se personi pastron sipas manualit të përdoruesit të makinës. Dëshmi se personi përdor mjetet e nevojshme për mirëmbajtje dhe pastrim.

Evidenca e njohurive – Test me shkrim, demonstrim praktik i funksioneve dhe kritereve të performancës nëpërmjet softuerëve përkatës, aktivitete gjatë orëve mësimore, etj.

Funksioni 3: Prodhimi, montimi, demontimi dhe mirëmbajtja e dyerve dhe dritareve nga alumini

Ky funksion ka të bëjë me prodhimin e dyerve dhe dritareve nga alumini, përpunimin e pjesëve të dyerve dhe dritareve me makina konvencionale apo automatike, montimin e xhamave në dyer dhe dritare, ambalazhimin dhe deponimin pjesët e përpunuara brenda vendit të punës, po ashtu demontimin dhe montimin e dyerve dhe dritareve në ambiente të ndershme dhe kryerjen e llogaritjeve të thjeshta ekonomike.

Aktivitetet kyçe	Kriteret e Përformancës	Njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe dhe shkathtësitë e shoqëruara me funksionet kyçe
1. Përgatit veglat dhe pajisjet për prodhimin e dyerve dhe dritareve nga alumini	<ol style="list-style-type: none"> 1. Skicoj vizatime të thjeshta dhe interpretojë vizatimet me saktësi dhe në mënyrë efikase dhe kryen përpunimin e elementeve duke shfrytëzuar llogaritje të thjeshta matematikore; 2. Përzgjedh makinën për prodhimin e pjesëve të punës; 3. Përzgjedh gysmëfabrikatin nga alumini sipas kërkesave të punës në makinën përkatëse; 4. Zgjedh regjimin e duhur të punës; 5. Zgjedh veglat e nevojshme për prerje, frezim dhe shpim 	<ol style="list-style-type: none"> a) Interpreton skicat dhe vizatimet e thjeshta dhe interpretojë vizatimet me saktësi dhe në mënyrë efikase; b) Përzgjedh veglat dhe pajisjet e nevojshme për përpunimin e pjesëve të punës; c) Përshkruan proceset teknologjike për të realizuar përpunimin e pjesëve standarde; d) Shpjegon instrumentet prerëse për prerje-sharritje, shpim dhe frezim; e) Tregon llojet e veglave dhe pajisjeve për prerje, frezim dhe shpim. f) Përshkruan rregullat e përgjithshme për mirëmbajtjen e makinave për prerje, frezim, shpim. 	<ul style="list-style-type: none"> - Lexon dhe interpreton skicat dhe vizatimet e thjeshta. - kryen llogaritje të thjeshta; - Përgatit vendin e punës; - Siguron dokumentacionin teknologjik - Përgatit makinën për punë; - Përgatit veglat për punë; - Zbaton standardet për siguri në punë dhe ruajtje të mjedisit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi - Mbledh dhe përpunon informata - Të menduarit logjik - Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve - Të manifestoj guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësi - Të jetë vendimmarrës - Punë në grup - Vlerësimi dhe vetëvlerësimi

	<p>bazuar në vizatimin e detajuar dhe verifikon gjendjen e tyre;</p> <p>6. Përgatit makinën për punë duke u bazuar në vizatim të hollësishëm, në gjysëmfabrikatin e dhënë dhe në veglat prerës që duhet të përdoret;</p> <p>7. Zbaton standardet për siguri ne pune dhe ruajtje te mjedisit.</p>	<p>(lubrifikantët dhe ftohësit, filtrat, etj);</p> <p>g) Përshkruan vendosja dhe fiksimi i instrumenteve prerëse;</p> <p>h) Përshkruan proceset teknologjike të makinës prerëse, shpuese dhe frezuese;</p> <p>i) Tregon rregullat e sigurisë ne pune dhe ruajtje te mjedisit.</p>		
<p>2. Përpunon pjesët e dyerve dhe dritareve nga alumini.</p>	<p>1. Vendosja e gjysëmfabrikantit ne makine;</p> <p>2. Fiksimi i gjysëmfabrikantit ne makinë;</p> <p>3. Vendosja e veglës ne makinë;</p> <p>4. Kryerja e operacionit te prerjes duke përzgjedhur veglën dhe regjimin e përpunimit;</p> <p>5. Kryerja e operacionit te frezimit duke përzgjedhur veglën dhe regjimin e përpunimit;</p>	<p>a) Përshkruan mënyrat e vendosjes dhe fiksimit te gjysëmfabrikatit nga profile alumini ne makine;</p> <p>b) Tregon veglat prerëse qe përdorura për prerje, frezim dhe shpim ;</p> <p>c) Tregon makinat për prerje, frezim dhe shpim, parimet e tyre operative, struktura dhe sistemi i kontrollit;</p> <p>d) Përshkruan proceset teknologjike për të realizuar përpunimin e elementeve standarde për dyer dhe dritare te</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vendos dhe fikson gjysme fabrikantin e aluminit ne makinën përkatëse; - Vendos veglën prerëse për prerje te aluminit; - Rregullon makinat sipas regjimit të përpunimit; - Kryen operacionet e përpunimit me prerje te elementeve për dyer e dritare nga alumini; - Kryen operacionet e 	<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi - Mbledh dhe përpunon informata - Të menduarit logjik - Shkathësi në zgjidhjen e problemeve - Të jetë kritik dhe konstruktiv - Të manifestoj guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësive - Të jetë vendimmarrës - Mësimi gjatë gjithë jetës - Punë në grup - Vlerësimi dhe vetëvlerësimi

	<p>6. Kryerja e operacionit te shpimit duke përzgjedhur veglën dhe regjimin e përpunimit;</p> <p>7. Lidhja e pjesëve te dverve apo dritareve te aluminit- AL sipas kërkesave te punës (dyer te hyrjes, dyer ngritëse dhe rrëshqitëse, dyer ballkoni, dyer te brendshme, dritare me hapje paralele dhe ne kënd, dritare rrethore dhe këndore);</p> <p>8. Vendosa e panelit apo xhamit ne kornizën e te gjitha llojeve te dverve nga alumini;</p> <p>9. Vendosja e xhamit ne te gjitha llojeve te dritareve nga alumini</p>	<p>aluminit;</p> <p>e) Tregon rregullat e përgjithshme për mirëmbajtjen e makinës për prerje, frezim dhe shpim (lubrifikantët dhe ftohësit, filtrat, etj);</p> <p>f) Përshkruan proceset terminologjia që ka të bëjë me prerjen, frezimi dhe shpimin, vendosjen e elementeve etj. (në gjuhën amtare dhe të paktën në një gjuhë të huaj);</p> <p>g) Tregon metodologjia e vendosjes se panelit ne te gjitha llojet e dverve te aluminit;</p> <p>h) Tregon metodologjia e vendosjes se xhamit ne te gjitha llojet e dverve dhe dritareve te aluminit-AL.</p>	<p>përpunimit me frezim te elementeve për dyer e dritare nga alumini;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryen operacionet e përpunimit me shpim te elementeve për dyer e dritare nga alumini; - Monton elementet e dverve dhe dritareve nga alumini; - Vendos panelin apo xhamat ne dyer apo dritare; - Zbaton standardet për siguri ne pune dhe ruajtje te mjedisit. 	
